


Pranuar me dt. 19.04.2024			
Njesia organ.	Numer	Nr.Ekzempl.	Vlera
	151		



**Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +383-28530446



## MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLË

NË MES TË

**UNIVERSITETIT "ISA BOLETINI" NË MITROVICË  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE**

DHE

**KOMPANISË "BYLMETI-KS Sh.p.k" MIRADI E EPËRME – FUSHË KOSOVË**

### **I. Qëllimi i Marrëveshjes**

Përmes kësaj marrëveshje të bashkëpunimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim dhe njohje të ndërsjellë duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve dhe njohurive profesionale. Qëllimi i bashkëpunimit mes palëve nënshkruese është që të kontribuohet në ngritjen e relevancës dhe përshtatshmërisë së sektorit të edukimit me ato të nevojave të tregut si dhe të sigurohet ndikimi pozitiv në rritjen e efikasitetit dhe efektshmërisë së bizneseve në sektorin e inxhinierisë, teknologjisë ushqimore, ekonomisë.

### **II. Fushëveprimtaria**

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore në Mitrovicë dhe Kompania "Bylmeti" Miradi e Epërme - Fushë Kosovë në kuadër të bashkëpunimit do ta ndihmojnë njëra-tjetrën në bazë të veprimtarisë që e zhvillojnë. Studentët e UIBM-së do ta zhvillojnë punën praktike-profesionale në kompaninë "Bylmeti" Miradi e Epërme - Fushë Kosovë. Ky bashkëpunim do të reflektoj në ngritjen e kapaciteteve humane me kërkesat e tregut të punës, në trajnime dhe seminare të ndryshme që të aftësohen profesionalisht resurset humane brenda sektorit për të rritur sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e sektorit ekonomik dhe aplikimin e metodave dhe praktikave më të mira në laboratorët e kompanive të kësaj qendre.

Fushat e përgjithshme të bashkëpunimit specifikohen në:

1. Bashkëpunimi dhe ndihma teknike, ofrimi i mundësisë në realizimin e punës praktike (laboratorike) të studentëve të (FTU-së), Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë
2. Bashkëpunimi dhe ndihma teknike që ju jepet studentëve në realizimin e punimeve të seminarit dhe në punimin e diplomave në nivelet e studimeve themelore dhe master, shfrytëzimi i laboratoreve në kuadër kompanisë “Bylmeti” Miradi e Epërme - Fushë Kosovë, dhe anasjelltas.
3. Bashkëpunimi me qëllim të ngritjes së mundësive respektive për mbështetje profesionale, shkencore, teknike, etj. për palët e treta.
4. Organizimi i takimeve dhe e konsultimeve për çështje të ndryshme me interes të përbashkët.
5. Bashkëpunimi në zhvillimin e projekteve të përbashkëta dhe aplikimi tek donatorët e mundshëm në fushat respektive.
6. Bashkëpunimi në ngritjen e kapaciteteve njerëzore në specializimet për zhvillimin e karrierës së studentëve apo edhe të kuadrove nga kompania “Bylmeti” Miradi e Epërme - Fushë Kosovë, në programet dhe projektet e FTU-së, Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

### **III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni**

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuar sipas kësaj marrëveshje të mirëkuptimit do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuara me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjëherë palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë marrëveshje apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij pa aprovim paraprak të palës tjetër.
2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjellët me besueshmëri të plotë;
3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e kësaj marrëveshje, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

### **IV. Organizimi dhe menaxhimi i programeve**

Palët nënshkruese, Kompania “Bylmeti” Miradi e Epërme - Fushë Kosovë dhe Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë (Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore), do t’i caktojnë personat përgjegjës për zhvillimin dhe koordinimin e programeve dhe aktiviteteve të përcaktuara nga qëllimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshje. Përveç kësaj, do të caktohet kontakt personi apo koordinatori në secilin institucion për të mbikëqyrur dhe menaxhuar aktivitetet të cilat rrjedhin nga ky bashkëpunim. Përgjegjësitë specifike të kontakt personit apo koordinatorit do të varen

nga lloji i aktivitetit apo programit dhe ato do të përcakohen nga një klauzolë përkatëse nëse palët e shohin të nevojshme.

## V. Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është pesëvjeçare, e cila do të rishikohet pas kësaj periudhe për të siguruar që qëllimi dhe zbatimi është bërë siç është synuar. Nëse njëra prej palëve dëshiron të anulojë këtë marrëveshje, atëherë një njoftim paraprak duhet të dërgohet së paku një muaj më parë.

## VI. Vlerësimi

Programet dhe aktivitetet duhet të raportohen dhe vlerësohen pas përfundimit të aktiviteteve apo periudhës njëvjeçare. Të dy institucionet do të mbajnë takime të herëpashershme për të shqyrtuar realizimin apo ndryshimet tjera që mund të ndikojnë në përmbajtjen e kësaj marrëveshje.

## VII. Zbatimi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur përfaqësuesit e të dy institucioneve vendosin nënshkrimin e tyre në këtë dokument.



## VIII. Financimi

Të dyja palët kuptojnë se marrëveshjet financiare do të duhet të negociohen dhe varen nga disponueshmëria e fondeve. Për të rritur bashkëpunimin, të dyja palët pajtohen që të aplikojnë për financim të jashtëm nga burimet private dhe ato publike.

Palët nënshkruese:

**Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë  
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore**

Dekani: Prof. asoc. dr. Mensur Kelmendi



**Kompania "Bylmeti" Miradi e Epërme – F.Kosovë**

Menaxheri i prodhimit: Afrim Selmani

